



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKT LIGJ

Nr. _____, datë _____ 2019

**“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998 “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve: 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

Neni 1

Në nenin 8/1 “Të ardhura të përjashtuara”, pas pikës 13, shtohet pika 14 me këtë përmbajtje:

“14. Shpërblimet nga buxheti i shtetit që u jepen sportistëve apo ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni përkatës, për rezultatet e arritura në garat kombëtare dhe ndërkombëtare.”

Neni 2

Në nenin 20 “Shpenzime të njohura”, në paragrafin e dytë, togefjalëshi “...fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore...” zëvendësohet me togefjalëshin: “...faturë, e cila është lëshuar në përputhje me ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”...”.

Neni 3

Në nenin 21 “Shpenzimet e panjohura”, shkronja “j” e pikës 1, pas fjalisë së parë, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Nuk njihen si shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në ligjin nr. 7892 datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet” , i ndryshuar.

Për personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milion lekë, shumat e sponsorizuara, brenda kufijve të parashikuar në ligjin Për sponsorizimet, për veprimtaritë e ekipeve sportive pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, për efekt të përlllogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar. Nuk lejohet mbartja e tyre në periudhat tatimore të ardhshme.

Parashikimet e këtij paragrafi aplikohen pas lëshimit të "Autorizimit të Sponsorizimit" nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas procedurave të parashikuara në Udhëzimin e Ministrisë përgjegjëse për financat.”

Neni 4

Në nenin 27 “Mbartja e humbjeve”, pas paragrafit “1” shtohet paragrafi “1/1” me këtë përmbajtje:

“1/1. Për tatimpaguesit, të cilët investojnë në projekte biznesi me vlerë mbi 1 miliard lekë, në rast se fitimi i tatueshëm në një periudhë tatimore rezulton negativ, humbjet e rezultuara mund të mbulohen me fitimet në pesë periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit "humbja e parë më përpara se ajo e fundit". Ministri i financave sqaron me udhëzim kriteret dhe procedurat për zbatimin e këtij paragrafi. ”

Neni 5

Në nenin 28 “Shkalla tatimore”, pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Për personat juridikë të cilët ushtrojnë aktivitet në industrinë automotive, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %. Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, aktivitetet dhe procedurat për zbatimin e këtij paragrafi.”

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të nenit 2 i cili i hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI